



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 04/L-214**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-072 PËR  
KONTROLLIN DHE MBIKËQYRJEN E KUFIRIT SHETËRORË**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-072  
PËR KONTROLLIN DHE MBIKËQYRJEN E KUFIRIT SHETËRORË**

**Neni 1**

Titulli i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

**Ligji për Kontrollin e Kufirit Shtetëror**

**Neni 2**

Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Kontrolli kufitar përfshin kontrollimin dhe mbikëqyrjen e kufirit, analizën e kërcënimeve dhe rreziqeve për sigurinë nacionale të cilat mund të ndikojnë në sigurinë e kufirit dhe kryhet me qëllim të:

### Neni 3

1. Neni 3 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.3. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.3. **Kontrolli kufitar** – aktivitet i kryer në kufi në pajtim dhe për qëllimet e këtij ligji, dhe vetëm në përgjigje të një tentimi të kalimit apo aktit të kalimit të atij kufiri, pavarësisht tjetër konsiderate, e përbërë nga kontrollimi kufitar dhe mbikëqyrja kufitare.

2. Neni 3 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.4. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.4. **Mbikëqyrje kufitare** - mbikëqyrja e kufirit shtetëror ndërmjet pikave të kalimit kufitar dhe mbikëqyrja e pikave të kalimit kufitar jashtë orarit të caktuar të punës me qëllim që të pengohet shmangia e kontrollimit kufitar të personave.

3. Neni 3 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.6., riformulohet me tekstin si në vijim:

1.6. **Zonë e pikës së kalimit kufitar**- hapësira e cila është e nevojshme për kryerjen e kontrollimit kufitar dhe procedurave tjera kufitare, si dhe rrethina e drejtpërdrejt me objektet të cilat nevojiten për zhvillim të papenguar dhe të sigurt të trafikut, kontrollimit kufitar dhe procedurave tjera kufitare.

4. Neni 3 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.10. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.10. **Kontrollimi në vijën e dytë** - kontrollimi i mëtejshëm i cili mund të realizohet në vend të posaçëm jashtë vendit ku kontrollohen të gjithë personat, (vija e parë).

5. Neni 3 i ligjit bazik, pas nënparagrafit 1.11. shtohen nënparagrafët e rinjë 1.12. dhe 1.13 me tekstin si në vijim:

1.12. **Kontrollimi kufitar** – kontrollimi i kryer në pikat e kalimit kufitar për të siguruar që personat, mallrat dhe mjetet e tyre të transportit janë të autorizuar të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës apo të lëshojnë Republikën e Kosovës;

1.13. **Transportuesi** - një person fizik ose juridik profesioni i të cilit është të ofroj transportimin e personave.

### Neni 4

Në nenet: 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 31 paragrafi 2. dhe 5., nenet 32, 33, 36, 56, 57, 59, 60, 61 dhe 62 të ligjit bazik, termi “**kontrolli kufitar**” zëvendësohet me termin “**kontrollimi kufitar**” .

## Neni 5

Pas nenit 7 të ligjit bazik shtohet neni i ri 7.A me tekstin si në vijim:

### Neni 7.A Autorizimet e Veçanta

Përgjegjësitë e Policisë Kufitare për të lëshuar viza në pikat e kalimit kufitar në raste të veçanta, për të refuzuar hyrjet apo për të anuluar vizat rregullohet me dispozita të veçanta të parapara në Ligjin për të Huajt dhe legjislacionin përkatës.

## Neni 6

Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Kontrollimet kufitare mund të kryhen edhe jashtë zonës së pikës së kalimit kufitar, në tren, mjet fluturimi, ose në ndonjë vend tjetër brenda territorit të Republikës së Kosovës siç është specifikuar në nenin 46 të ligjit bazik.

## Neni 7

Neni 12 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.2., riformulohet me tekstin si në vijim:

1.2. të kontrolloj nëse janë plotësuar kushtet për hyrje dhe dalje nga Republika e Kosovës të përcaktuara me ligjin për të huajt, të jap udhëzime dhe urdhra me qëllim të kryerjes së shpejtë dhe të papenguar të kontrollimit kufitar.

## Neni 8

1. Neni 15 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.3 termi “**rishikimi**” zëvendësohet me termin “**ekzaminimi**”.

2. Neni 15 i ligjit bazik paragrafi 1. nënparagrafët 1.1., 1.5., 1.6., paragrafi 2. nënparagrafët 2.1., 2.3., dhe paragrafi 3. nënparagrafët 3.1., dhe 3.2. termi “**konstatimi**” zëvendësohet me termin “**verifikimi**”

3. Neni 15 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.2. termi “**ekzaminimi**” zëvendësohet me termin “**shqyrtimi**”.

4. Neni 15 i ligjit bazik paragrafi 4, termi “**mund**” zëvendësohet me termin “**duhet**”.

5. Neni 15 i ligjit bazik, paragrafi 5 riformulohet me tekstin si në vijim:

5. Shtetasit e huaj të cilët i nënshtrohen kontrollimit kufitar të plotë në vijë të dytë, informohen për qëllimin dhe procedurën e kryerjes së kontrollimit, si dhe mundësinë që të kërkoj emrin dhe mbiemrin, numrin identifikues të zyrtarëve policor kufitar të cilët e kryejnë kontrollin kufitar të plotë, emrin e pikës së kalimit kufitar dhe datën kur është kaluar kufiri.

### **Neni 9**

Pas nenit 15 të ligjit bazik shtohet neni i ri 15.A me tekstin si në vijim:

#### **Neni 15.A Kontrollimi në vijën e dytë**

1. Në rastet kur ekziston nevoja për të bërë verifikime shtesë ose kur ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi mund të jetë i përfshirë në aktivitete të kundërligjshme, zyrtari policor kufitar duhet ta shoqëroj personin apo automjetin në një vend tjetër nga vija e kontrollimit për të kryer kontrollime shtesë (vija e dytë e kontrollimit).
2. Kontrollimi në vijën e dytë, kur këtë e lejojnë kushtet, duhet gjithmonë të kryhet në vend të posaçëm dhe ndaras nga vija e parë.

### **Neni 10**

Pas nenit 24 të ligjit bazik shtohet neni i ri 24. A me tekstin si në vijim:

#### **Neni 24.A Detyrimet e transportuesit**

Detyrimet e transportuesit do të zbatohen sipas dispozitave ligjore të Ligjit për të Huajt.

### **Neni 11**

Neni 25 i ligjit bazik, pas paragrafit 6. shtohet paragraf i ri 7. me tekstin si në vijim:

7. Gjatë kryerjes së kontrollimit kufitar në trafikun hekurudhor, Policia Kufitare bashkëpunon me organet Policore të huaja, në pajtim me Marrëveshjet Ndërkombëtare.

## **Neni 12**

Pas nenit 26 të ligjit bazik, shtohet neni i ri 26.A me tekstin si në vijim:

### **Neni 26.A Trafiku lokal kufitar**

1. Banoret e zonës kufitare që kanë një leje për trafikun lokal kufitar mund të kalojnë kufirin tokësor të Republikës së Kosovës nën një regjim të trafikut lokal të kufirit.
2. Duhet të nënshkruhen Marrëveshje Bilaterale me shtetet fqinje për trafikun lokal kufitar për kalimin e rregullt të kufijve të përbashkët nga banorët e zonës kufitare për të qëndruar në zonë të kufirit.
3. Regjimi i trafikut lokal kufitar do të strukturoj heqjen e rregullave të përgjithshme të kontrollit të kufirit për personat që kalojnë kufirin. Kalimi i kufirit nga banorët lokal të kufirit është e lehtësuar si më poshtë:
  - 3.1. lëshimi i dokumenteve speciale që përdoren për kalimin e kufirit ndryshe nga pasaportat. Nuk duhet të jepen vula të hyrjes apo daljes në dokumentet speciale të trafikut lokal të kufirit;
  - 3.2. vendosja e hyrjeve speciale kufitare të hapura vetëm për banorët e zonës kufitare;
  - 3.3. rezervimin e korsive të veçanta për banorët e kufirit tek hyrjet e rëndomta kufitare; ose
  - 3.4. marrja parasysh e rrethanave lokale, dhe aty ku në mënyrë të veçantë ka ndonjë kërkesë të natyrës speciale, autorizimi për banorët e zonës kufitare të kalojnë kufijtë e tyre të jashtëm tokësor në pjesë të definuar veç hyrjeve të autorizuara kufitare dhe jashtë kohës së caktuar.
4. Kontrolli kufitar nën regjimin e trafikut lokal kufitar do të sigurojë që banorët lokal nuk konsiderohen që janë kërcënim për politikën publike, sigurinë e brendshme, shëndetin publik apo për marrëdhëniet ndërkombëtare.
5. Kushtet dhe procedurat për trafikun lokal kufitar, përfshirë lëshimin e lejeve për trafikun lokal kufitar, rregullohen me akt nënligjor që miratohet nga Ministria e Punëve të Brendshme.

## **Neni 13**

Neni 48 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Bashkëpunimi nga paragrafi 1. i këtij neni rregullohet me ligj të veçantë.

#### **Neni 14**

Pas nenit 63 të ligjit bazik shtohet neni i ri 63.A me tekstin si në vijim:

#### **Neni 63A**

#### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me organet tjera shtetërore nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

#### **Neni 15**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji nr. 04/L-214**  
**31 korrik 2013**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**